



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:172041

Datë: 18.12.2024

Numri i dokumentit: 06618265

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.716/22

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, me gjyqtarin e vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrjen e praktikantit gjyqësor Zyhdi Hajzeri, në çështjen penale kundër të pandehurit E.D.për shkak të veprës penale sulm nga neni 184 par 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshme PP/II-nr.1548/22 të datës 10.08.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 18.12.2024 në prezencë të Prokurores së Shtetit Lumturije Hoxha dhe të pandehuri E.D., të njëjtën ditë mori, shpalli publikisht dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri,

E.D., i lindur më datë 2.....9.01.1987 në fsh. V. K. Pejë, tani banon në fsh. T.K. Pejë, nga babi Murat dhe nëna Z. e gjinisë Sh ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar me numër personal, posedon numër të telefonit Boshnjak, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar me parë, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datën rreth orës 22:30 min në fsh. V. K. Pejë, pikërisht në loaklin “ H.”, me dashje ka përdorur forcë ndaj të dëmtuarit E.S., në atë mënyre qe deri sa i dëmtuari ishte ne lokalin e lartcekur, i pandehuri ja zgjatë dorën që të përshëndes të dëmtuarin, mirëpo i dëmtuari për shkak të një mosmarrëveshje të mëhershme nuk dëshirën që t’ia jap dorën, kështu që i pandehuri e fton të dëmtuarin që të dalin jashtë lokalit, e pasi që dalin jashtë, i pandehurin fillon ta godas me grushta te dëmtuarin ku ndërhyjnë sigurimi i lokalit dhe e largon të pandehurin nga i dëmtuari,

-me çka ka kryer veprën penale sulm nga neni 184 par 1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të nenit 7, 17, 38, 39, 43, 69, 70, 71 dhe 184 të KPRK-së, 7, 8 dhe 364 të KPPRK-së, të pandehurit E.D.shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumën prej 400,00 € (katërqind euro), të cilin dënim obligohet i pandehuri ta paguaj në afat prej 2 (dy) muajve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin e mbetur me gjobë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burg, ku një ditë burg do ti llogaritet 20 euro.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 40 € (dyzet) euro në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

I dëmtuari E (B) S me banim në fsh. D K. Istog, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest të rregullt civil.

Arsyetim.

Prokuroria Themelore në Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme me datën 10.08.2022 ka ngritur aktakuzë PP/II-nr.1548/22 kundër të akuzuarit E.D.për shkak të veprës penale sulm nga neni 184 par 1 të KPRK-së.

Ne shqyrtimin fillestar të datës 18.12.2024 gjykata ne pajtim me nenin 241 par. 1 të KPPRK-se e ka udhëzuar te pandehurin për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaroi për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmin, as të pranojë fajësinë, të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij, të kundërshtojë aktakuzën dhe provueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.

Ne shqyrtim fillestar gjykata është bindur se i pandehurit e ka kuptuar aktakuzën dhe nuk kanë nevojë për sqarime shtesë. Me pas gjykata e ka njoftuar te pandehurin për pasojat dhe benefitet e pranimit te fajësisë.

I pandehuri është deklaruar fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar duke shtuar se: jam penduar dhe shton se është e vërtetë që e kam kryer këtë vepër, kam qenë i provokuar dhe i kërkoj falje te dëmtuarit.

Në vlerësimin e pranimit te fajësisë nga ana e te pandehurit gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e Prokurorit te Shtetit i cili ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit, i njëjti pranim është bere ne mënyrë vullnetare nga i pandehuri dhe po ashtu gjen mbështetje ne shkresat e lëndës.

Gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se ne seancën e shqyrtimit fillestar nuk ekzistojnë rrethana për hedhjen e aktakuzës nga neni 248 par. 1 pika 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 te KPPRK-se, si dhe janë vërtetuar faktet nga neni 242 par. 6 të KPRK-se, ngase aktakuza mbështet ne këto prova: Raporti

fillestar i incidentit me numër të rastit datës 26.07.2022, njoftim i përpiluar nga hetuesi S Hamziq i dt. 26.07.2022, raporti i policit E D i dt. 27.07.2022, deklarata e të pandehurit E. D e dhënë në polici me dt. 26.07.2022, deklarata e të dëmtuarit E. S. e dhënë në polici me dt. 26.07.2022, deklarata e dëshmitarit M. G. e dhënë në polici me dt. 26.07.2022, si dhe të bëhet shikimi në shkresat e tjera të lëndës, andaj ka marr aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri duke caktuar shpalljen e aktgjykimit menjëherë meqenëse nuk kishte propozime të tjera nga palët në procedurë.

Andaj me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i cili mbështet në provat në baze të cilave bazohet aktakuza është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale nga neni 184 par. 1 lidhur me par 1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 par.1, 2 dhe 3 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurit, gjykata mori pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurit, si dhe faktin se me parë nuk ka qenë i dënuar, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata nuk ka gjetur.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vlerësuar se me dënimin e shqiptuar si në dispozitat të këtij aktgjykimi mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në nenin 449 të KPPRK-së, gjykata i obligoi të akuzuarin që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe atë për paushallit gjyqësor në shumë prej 20,00 € dhe për taksën për programin për kompensimin e viktimave të krimit 20,00 €.

Komfor nenit 462 par. 3 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarën e udhëzoi në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa komfor nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
2022:172041, 18.12.2024

Praktikanti gjyqësor

G j y q t a r i

Zyhdi Hajzeri

Musë POVATAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.